

RRITJA E AKSESIT NË ARSIMIN PARASHKOLLOR – PËRFITIMET DHE SFIDAT

nga Evis ÇELA – Kryeaudituese¹

botuar në gazetën “Ekonomia”, më 31 maj 2014.



Nëpërmjet auditimeve të performancës, tashmë Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konsoliduar një funksion tjetër shumë të rëndësishëm: atë të këshillimit. Në një prej auditimeve më të fundit të kryer nga ky institucion, është adresuar ndër të tjera një çështje shumë e rëndësishme, aksesin në arsimin parashkollor.


Prindërit shpesh gjenden përballë një zgjedhje nëse duhet ti dërgojnë në kopësht ose jo fëmijët e tyre të moshës 3-6 vjeçare. Sidomos në vendin tonë, me një

situatë të caktuar ekonomike-sociale, vihet re se edhe pse është një shërbim falas i ofruar nga shteti, prindërit nuk i dërgojnë fëmijët në kopësht dhe zgjedhin të përkujdesen për ta në forma të tjera, nëpërmjet gjyshërve ose kujdestarëve. Por sot fëmija konsiderohet një subjekt aktiv që përfshihet në bashkëveprimin e vazhdueshëm me bashkëmoshatarët, të rriturit dhe mjedisin social dhe kulturor ku bën pjesë. Ky përfytyrim për fëmijët ka nxitur në mbarë botën rritjen në aksesin parashkollor dhe studime të shumta që mbështesin idenë se fëmijët duhet të ndjekin domosdosmërisht vitet e kopshtit.

Shumë fëmijë, sidomos ata në zonat më pak të zhvilluara të vendit, hyjnë në shkollën fillore të papërgatitur siç duhet. Këta fëmijë kanë tendencën të ngelen mbrapa dhe të avancojnë pak më me vështirësi se fëmijët e tjerë që kanë ndjekur kopshtin. Kjo ndodh për arsyen se fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor hyjnë në shkollën fillore me aftësi lexuese e gjuhësore më të mira, fjalor më të pasur dhe aftësi bazë matematikore më të zhvilluara, në krahasim me ata që nuk e kanë ndjekur atë.

Studime të shumta kanë treguar se investimi në kapitalin njerëzor, që në fëmijërinë e hershme, ka një normë të lartë kthyeshmërie në të ardhmen e tyre. Kështu, në një studim të kryer në vitin 2007 nga Grantham-McGregor, ka rezultuar se arsimi parashkollor është mënyra më e mirë për të zhvilluar aftësitë njohëse dhe socio-emocionale tek fëmijët përpara se ata të fillojnë arsimimin e detyrueshëm parësor.

Sipas këtij studimi, programet e arsimit parashkollor janë gjithashtu edhe ndërhyrjet me raportin më optimal kosto-efektivitet në të gjithë nivelet shkollore që lidhen me edukimin. Të dhënat e këtij studimi, por edhe ato të kërkimeve të tjera shkencore ndërkombëtare, tregojnë se programet e edukimit parashkollor kanë një kthyesmëri më të madhe, krahasuar me edukimin e viteve të mëvonshme. Sigurisht që përfitimi nga kjo ndërhyrje maksimizohet kur fokus grupi janë fëmijët e familjeve në vështirësi.



Burimi: "Human Capital Policy", P. Carneiro and J. Heckman, 2004, Fig.2.6, Panel A, f.91

Nga ana tjetër, një grup studiuesish në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvillojnë prej vitesh një projekt, të quajtur "Perry Preschool Project", i cili ka filluar që në vitin 1960. Ky studim ka krahasuar dy grupe të ndryshëm fëmijësh, ata që kanë ndjekur edukimin parashkollor dhe ata që nuk e kanë ndjekur atë. Prej 40 vjetësh mblidhen të dhëna në lidhje me këta fëmijë dhe ka rezultuar se ata që kanë ndjekur arsimin parashkollor, kanë vazhduar më tej shkollën e lartë dhe kanë pasur më shumë mundësi për të gjetur një punë në krahasim me ata që nuk kanë frekuentuar asnjë vit edukimi parashkollor.

Por si është situata në vendin tonë, krahasuar me rajonin apo vendet e OECD? Në Shqipëri arsimit parashkollor është pjesë e arsimit parauniversitar dhe ka të bëjë vetëm me fëmijët e moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet. Në ligjin nr.69, datë 21.06.2012 "Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet se "...arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe

përgatitjen për arsimin fillor. Ky nivel arsimor ndiqet nga fëmijët e moshës tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyruar.”

Pothuajse në të gjithë vendet e Europës (si psh Greqi, Poloni, Serbi, Bullgari etj) edukimi parësor fillon me një vit përgatitor parashkollor, i cili është i detyrueshëm, ndërkohë që aktualisht në Shqipëri fëmijët e moshës 5-6 vjeç kanë të drejtën, por jo detyrimin, të ndjekin një vit përgatitor parashkollor.

Gjatë auditimit tashmë të përfunduar nga Departamenti i Performancës në KLSH, është kryer një analizë më e detajuar në lidhje me pjesëmarrjen në arsimin parashkollor, ku ka rezultuar se nga 28752 fëmijë të moshës 3-6 vjeç të regjistruar në Tiranë, vetëm 39% e tyre ndjekin kopshtet publike apo private. Aksesit i fëmijëve në arsimin parashkollor në Tiranë është ende i ulët, në krahasim me mesataren e vendeve të OECD ku niveli i pjesëmarrjes së fëmijëve në kopshte është **82%**. Nga ana tjetër, pas analizimit të të dhënave të marra nga Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, ka rezultuar se në vitin shkollor 2012-2013, në kopshtet e Tiranës 4340 fëmijë të grupmoshës 5-6 vjeç ndjekin vitin përgatitor parashkollor. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me ato të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas të cilës në Tiranë për këtë vit shkollor janë 14376 fëmijët e kësaj grupmoshe, rezulton se përfshirja e fëmijëve në vitin përgatitor parashkollor është në nivelin 30%, nivel ky shumë herë më i ulët se mesatarja e vendeve të OECD, ku 90% e fëmijëve ndjekin të paktën një vit përgatitor parashkollor duke u nisur edhe nga fakti se në shumicën e këtyre vendeve ky nivel edukimi është i detyrueshëm.

Pra duke qenë se frekuentimi i çerdheve dhe kopshteve nuk është i detyrueshëm në Shqipëri, një pjesë e madhe e prindërve kanë zgjedhur të mos i regjistrojnë fëmijët e tyre në asnjë nga format e arsimit parashkollor. Ministria dhe Bashkia nuk kanë asnjë informacion për këtë grup fëmijësh, por mendohet se një pjesë e tyre mbahen nga gjyshërit, nga prindërit e pa punësuar apo nga kujdestare të cilat në Shqipëri janë akoma pjesë e ekonomisë informale.

Pjesëmarrja e fëmijëve në arsimin parashkollor në Shqipëri është mjaft e ulët edhe pse rritja e aksesit ka qenë pjesë e objektivave strategjike të MAS 2009-2013 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijët 2012-2015.

Kjo pjesëmarrje kaq e ulët ka një rëndësi të veçantë sidomos për fëmijët e moshës 5-6 vjeç, pasi kalimi nga kopshti në shkollë konsiderohet një moment i rëndësishëm për jetën e tyre. Vështirësitë që fëmijët përjetojnë kur kalojnë nga loja e mirëfilltë e

kopshtit në shkollë, mund të shkaktojnë stres dhe ankth. Në mënyrë që kalimi nga loja tek të nxënit, të jetë sa më i lehtë dhe i natyrshëm, nevojitet një periudhë përgatitore parashkollore.

Përballë një situatë të tillë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të funksionit të tij këshillues ka vendosur ti rekomandojë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të konsiderojë ***përfshirjen e nxënësve 5-6 vjeçarë në arsimin e detyruar me synim rritjen e aksesit në arsimin parashkollor dhe nxitjen e tyre për arsimin bazë***. Ky rekomandim jepet edhe në mbështetje të objektivave strategjike të kësaj Ministrie si dhe duke mbajtur në konsideratë praktikën më të mira apo Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të përcaktuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Kjo organizatë ka përcaktuar nxitjen e arsimit bazë duke përfshirë ndër të tjera edhe një fazë përgatitore për fëmijët, si një nga 8 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit për vendet anëtare të saj.

Nga ana tjetër, edhe vetë specialistët e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë dhe përfaqësues të UNICEF, theksojnë se nëse se viti përgatitor parashkollor do të bëhej i detyrueshëm, do ti siguronte një brezi të tërë fëmijësh një vit më tepër arsimim bazë por do të ndikonte gjithashtu edhe në përgatitjen më të mirë të tyre, pasi arsimit parashkollor lidhet ngushtë me një performancë më të lartë të nxënësve në vitet e mëvonshme të shkollës.

Një argument më tepër në mbështetje të rekomandimit të mësipërm është edhe programi ndërkombëtar PISA i vlerësimit të nxënësve që kryen OECD. Ky program ka konkluduar se nxënësit 15 vjeçarë që kanë ndjekur të paktën një vit edukimi parashkollor, kanë pasur rezultate më të mira në vitet pasuese të shkollës se sa ata që nuk kanë ndjekur asnjë vit edukimi parashkollor, madje edhe pasi është marrë në konsideratë kuadri i tyre social-ekonomik.

Rritja e aksesit në edukimin parashkollor përveç përfitimeve të shumta, sjell domosdoshmërisht nevojën për përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së këtyre institucioneve. Paralelisht me këtë proces, do të ishte e nevojshme të hartohet një fushatë sensibilizuese dhe informuese ndaj prindërve në mënyrë që ata të njihen me dobitë dhe përfitimet që fëmijët e tyre mund të kenë nga edukimi parashkollor.

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Evis ÇELA për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *Problematika me të cilat përballet “Shërbimi Parashkollor”.*

(Botuar në gazetën “Ekonomia”, më 11 qershor 2014.)